



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 114/ 2012**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega Ferizaj, paraqitur kundër, Kryesuesit të Vendvotimit Ilir Ahmeti, Nr.2523d/02R, Lloshkobare, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

### **VENDIM**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa, e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega Ferizaj.

### **Arsyetim**

PZAP, më datë 30.04.2010, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me datën 29.04.2012, në shkollën “Përparimi”, në Lloshkobare, në Qendrën e Votimit 2523d/02R, deri në orën 15:00, ka pasur 11 raste të votimit familjar. Vëzhguesi i subjektit politik LVV, ka arritur të sigurojë emrin e njërit prej votueseve, në njërin prej rasteve të votimeve familjare i cili quhet Limon Kokollari. Poashtu parashtruesi i ankesës, pretendon se vëzhguesi i subjektit politik LVV, ka tentuar të shënojë parregullsinë e ndodhur në librin e vërejtjeve, mirëpo sipas parashtruesit një gjë e tillë nuk është lejuar nga Kryesuesi i Vendvotimit Ilir Ahmeti. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë rast është bërë shkelje e Rregullës Zgjedhore 09/2009, neni 9.4 dhe 9.

Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë materiale, përveq ka cekur emrin e Sami Avdia në cilësinë e dëshmitarit.

PZAP-i, me datën 02.05.2012, ka ftuar në cilësinë e dëshmitarit, vëzhguesin e subjektit politik LVV, Sami Avdia, i cili në deklaratën dhënë PZAP-it, thekson se ka pasur votime familjare, duke e cekur emrin e njërit nga votuesit Limon Kokollari i cili kishte ardhur së bashku me gruan, kanë marrë fletëvotimet dhe kanë votuar së

bashku. Sipas deklaruësit, theksohet se për një veprim të tillë ka reaguuar tek Kryesuesi i Vendvotimit se ky veprim është votim familjar, por sipas tij kryesuesi nuk ka marrë parasysh këtë dhe në librin e tij ka shënuar si asistim në votim. Më tutje vëzhguesi në fjalë në cilësinë e dëshmitarit ka deklaruar se ka ndodhur edhe një rast ku votuesja e quajtur Alberta Jashari, ka shoqeruar motren e saj duke dashur që të votoj në emër të saj, vëzhguesi i LVV-së thekson se e ka pyetur votuesen se pse voton në emër të së motrës, ajo i është përgjigjur se nuk e njeh subjektin politik, vëzhguesi në deklaratën e tij thotë se e ka pyetur votuesen se a din shkrim dhe lexim e motra e saj dhe ajo i është përgjigjur se po, vëzhguesi LVV-së në deklaratën e tij vazhdon se kryesuesi ka lejuar një veprim të tillë. Në fund të deklaratës vëzhguesi thotë se ka pasur edhe 11 raste tjera të njëjta, mirepo Kryesuesi i Vendvotimit, në librin e votimit i ka shënuar si asistim në votim ose si shoqërues.

PZAP-i, me datë 01.05.2012, në mënyrë elektronike informoi Kryesuesin e Vendvotimit 2523d/02R, në Lloshkobare, për ankesën Anr.114/2012, që është bërë për parregullësitë në VV të lartpërmendur, dhe ka kërkuar që të përgjigjet deri me datë 02.05.2012 deri në ora 14:00.

PZAP-i, ka pranuar në mënyrë elektronike përgjigjen në ankesë me datë 02.05.2012, në të cilën përgjigje, Kryesuesi i Vendvotimit 2523d/02R, ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë parregullsi gjatë procesit të votimit me datën 29.04,2012, në vendvotimin e cekur, deri sa ka qenë kryesues, gjithashtu kryesuesi i VV sqaron se nuk ka pasur votim familjar dhe kërkesë ndaj tij nga vëzhguesi i subjektit politik i LVV-së për të regjistruar parregullsitë në Librin e Votimit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Nga ankesa e parashtruar në PZAP, dhe nga deklarata e dhënë nga vëzhguesi i subjektit politik LVV, që pretendon se kanë ndodhur parregullsi gjatë procesit të votimit si votim familjar dhe asistim në votim, nuk mund të konstatohen pretendimet ankimore, ngase parashtruesi i ankesës, nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë provë, si dëshmi relevante për të qenë të besueshme se kinse kanë ndodhur parregullsitë gjatë ditës së votimit. PZAP, gjeti se pretendimet ankimore në ankesë nuk qëndrojnë për faktin se nuk janë të bazuara në dëshmi të qarta dhe bindëse, andaj duke marrë parasysh këtë, një pretendim i tillë i ankesës u vlerësua si i pabazuar, andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartpërmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë**

Anr.114/2012 më datën 03.05.2012.

